# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

*Nr.* 64 *prot.* *Shkodër, më* 15.03. *2017*

**V E N D I M**

nr 33. prot. datë 15.03. 2017.

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë",neni 49; Ligj nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",në mbledhjen e datës 15.03.2017,me cilësinë e organit më të lartë drejtues administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, në mbledhjen e datës 03.03.2017,pasi diskutoi për nevojën e riorganizimit sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015,

**Vëren:**

Në përputhje me ligjinnr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është nëprocedurat përfundimtare të riorganizimit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Në këtë linjë në kuadër të detyrave që ligji i ngarkon Bordit të Administrimit për organizimin e konkursit për përzgjedhjen e administratorit të USH-së, Bordi i Administrimit vëren se duhet të procedohet me shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i institucionit" dhe caktimin e kritereve dhe procedurave për emërimin e Administratorit të USH-së.

Sa më sipër Bordi i Administrimit me unanimitet,

**V e n d o s i :**

1. Fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së".
2. Miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator i USH-së" sipas dokumentit bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari**

**EDUARD NDRECA**

# UNIVERSITETI ISHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

*Nr. 64/1 prot.* *Shkodër, më 15.03.2017*

### Shpallje për zgjedhjen e Administratorit të USH

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpall konkursin për pozicionin e punës "Administrator i institucionit".

Dokumentacioni i nevojshëm do të dorëzohet vetëm me postë në Rektoratin e USH deri në datën 03.04.2017 me shënimin mbi zarf "Aplikim për pozicionin e administratorit në USH".

Informacionin rreth kritereve dhe fushës së testimit do t'i gjeni bashkangjitur njoftimit.

Njoftimet e mëtejshme për datën dhe orën e konkursit do të shpallen në faqen web të Universitetit.

**Kryetari**

**EDUARD NDRECA**

## Kriteret e vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator" i Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër

**I. Kritere baze kualifikuese**

1. Të kenë përfunduar arsimin e lartë së paku në nivelin "Master i Shkencave".
2. Të kenë përfunduar studimet në fushën e drejtësisë ose ekonomisë me mesatare mbi 7.
3. Të kenë përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.
4. Të mos ketë procedim penal të filluar ndaj tyre për vepra penale gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore.
5. Të mos kenë lidhje apo konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi.

**Shënim**: Në rast se kandidatët nuk plotësojnë kriteret eliminuese të cituara më lart nuk mund të pranohen për konkurrim.

**Kritere preferuese**

6. Të njohin kuadrin ligjor dhe praktik të administrimit ekonomik dhe financiar të institucionit.
7. Të kenë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese e raportuese.
8. Të ketë aftësi të mira organizuese, komunikuese dhe të punës në grup.
9. Të njohin gjuhën angleze ose një nga gjuhët zyrtare të BE-së.
10. Të kenë kryer trajnime apo kualifikime në fushat ku konkurojnë.

**II. Intervista me gojë**

**Konsiston në :**

1. Përgjigjet e pyetjeve, përmes të cilave do të tregojnë aftësitë:
   a. Për të drejtuar dhe menaxhuar ekipin administrativ në IAL.
   b. Për të organizuar dhe ndarë punën në institucionin që drejton
   c. Për të bashkëpunuar me institucionet e tjera të IAL-ve
   d. Për të menaxhuar dhe zgjidhur situata emergjente ose të paparashikuara
   e. Për të marrë vendime të argumentuara në mënyrë objektive.
   f. Për të respektuar kolegët dhe vartësit, dhe për të konsideruar mendimin ndryshe.
   g. Për të përshtatur politikat ekzistuese me ide të reja për realizimin e objektivave të IAL-ve.
   h. Për të ndërmarrë nisma të ndryshme strategjikë dhe afatgjata brenda kompetencave, për përmbushjen e detyrave funksionale.
   i. Për shmangien e risqeve në realizimin e politikave inovative në IAL.

2. Përgjigjet e pyetjeve në njohuritë mbi legjislacionin në fuqi me karakter financiar dhe administrativ, kryesisht për:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Kodin e punës
- Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zënë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike (ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, ligji nr. 9000, datë 30/01/20113, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave");
- Programin dhe prioritet e MAS për Institucionet e Arsimit të Lartë;
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin mbi auditimin;
- Legjislacionin tatimor;
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Legjislacionin e prokurimit publik;
- Legjislacionin për menaxhimin financiar;
- Legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor (ligji nr. 9936, datë 26/06/2008);
- Legjislacionin për rregullat e etikës në administratën publike (ligji nr. 9131, datë 08/09/2003);

**III. Dokumentacioni:**

1. Letër-motivimi për pozicionin e punës, për të cilin do të konkurojë.
2. Dokumentin e identifikimit.
3. Curriculum vitae me fotografi.
4. Diplomën e shoqëruar me listën e notave. Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të kenë bërë njohjen e diplomës. (Kriter kualifikues)
5. Kopje të noterizuar të librezës së punës që vërteton përvojën e punës. (Kriter kualifikues)
6. Librezën e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore. (Kriter kualifikues)
7. Çertifikata trajnimesh apo kualifikimesh pasuniversitare (nëse ka)
8. Dëshmitë e gjuhëve të huaja nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ose nga një qendër e gjuhëve të huaja testimet e të cilës njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
9. Vërtetim nga Prokuroria, Gjykata, Përmbarimi dhe Drejtoria e Burgjeve e Ministrisë së Drejtësisë që nuk ka ndjekje penale. (Kriter kualifikues)
10. Raport mjekësor për aftësinë në punë.
11. Deklaratë kundrejt përgjegjësisë ligjore për konfliktin e interesit (Kriter kualifikues)

12. Deklaratë kundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit përpara 2 korrikut 1991 (Kriter kualifikues)
13. Deklaratë kundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete (Kriter kualifikues)
14. Formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit "për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" (Kriter kualifikues)
15. Çdo gjë që deklarohet në CV të jetë e dokumentuar dhe e noterizuar.
16. Dokumentat e dorëzuara të jenë në zarf të mbyllur

**Shënim**: Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e cituara në zarf të mbyllur vetëm me postë në Rektoratin e USH deri në datën 03.04.2017 me shënimin mbi zarf "Aplikim për pozicionin e administratorit në USH". Mungesa e dokumenteve për "kriteret kualifikuese" përbën shkak për skualifikimin nga kandidimi.

**IV. Konkurimi, vlerësimi dhe rezultati**

Administratori do të përzgjidhet nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur sipas kritereve të hartuara nga Bordi Administrimit të USH-së. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret, miratohet nga Senati Akademik i USH-së, e cila do të shpallet në website e USH-së të nesërmen e mbledhjes së Senatit të USH. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

Konkurimi konsiston në :

- Vlerësimin e dosjes së kandidatit deri në 30 pikë.
- Vlerësimin e njohurive të shprehura në intervistën me gojë, ku totali i pikëve është 70 pikë.

Data e shpalljes së rezultatit do të bëhet në një njoftim të dytë në faqen web të Universitetit të Shkodrës, pasi vijimi i procedurës varet nga mbledhja e Senatit Akademik të USH për miratimin e listës së kandidaturave që plotësojnë kriteret. Në shpalljen e rezultatit kandidatët do të renditen sipas pikëve të grumbulluara. Fituesi do të jetë ai me pikët maksimale.

Ankimimet për rezultatin mund të bëhen deri 5 ditë kalendarike pas shpalljes së rezultatit.

**Mënyra e vlerësimit**

Çdo anëtar i bordit do te ketë aq flete vlerësimi sa kandidate do te ketë, pyetjet do te bëhen atë dite përpara se te filloje konkurrimi . Secili anëtar bordi do te beje vlerësimet ne fletat e tyre te vlerësimit. Ne fund, secili anëtar bordi do te votoje për një kandidat i cili ne vlerësimet e tij ka piket maksimale. Nga ana tjetër sekretarja do te mbaje procesverbal të vecantë për të të gjithë përgjigjet e kandidatëve.

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Kryetari

EDUARD NDRECA

# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

*Nr._______ prot.* *Shkodër, më ___. ___. 2017*

**V E N D I M**

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë",neni 49; Ligj nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",në mbledhjen e datës 15.03.2017,me cilësinë e organit më të lartë drejtues administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, në mbledhjen e datës 03.03.2017,pasi diskutoi për nevojën e riorganizimit sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015,

**Vëren:**

Në përputhje me ligjinnr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është nëprocedurat përfundimtare të riorganizimit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Në këtë linjë në kuadër të detyrave që ligji i ngarkon Bordit të Administrimit për organizimin e konkursit për përzgjedhjen e administratorit të USH-së, Bordi i Administrimit vëren se duhet të procedohet me shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i institucionit" dhe caktimin e kritereve dhe procedurave për emërimin e Administratorit të USH-së.

Sa më sipër Bordi i Administrimit me unanimitet,

**V e n d o s i :**

1. Fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së".
2. Miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator i USH-së" sipas dokumentit bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari**

**EDUARD NDRECA**

# UNIVERSITETI ISHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

*Nr._______prot.* *Shkodër, më ___. ___. 2017*

**V E N D I M**

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë",neni 49; Ligj nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",në mbledhjen e datës 15.03.2017,me cilësinë e organit më të lartë drejtues administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, në mbledhjen e datës 03.03.2017,pasi diskutoi për nevojën e riorganizimit sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015,

**Vëren:**

Në përputhje me ligjinnr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është nëprocedurat përfundimtare të riorganizimit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Në këtë linjë në kuadër të detyrave që ligji i ngarkon Bordit të Administrimit për organizimin e konkursit për përzgjedhjen e administratorit të USH-së, Bordi i Administrimit vëren se duhet të procedohet me shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i institucionit" dhe caktimin e kritereve dhe procedurave për emërimin e Administratorit të USH-së.

Sa më sipër Bordi i Administrimit me unanimitet,

**V e n d o s i :**

1. Fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së".
2. Miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator i USH-së" sipas dokumentit bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari**

**EDUARD NDRECA**